



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:012843
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05604434

KPPP.nr.1601/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Unikos” Sh.p.k., me NUI:810411629, me seli në Pejë, Rr.”Bill Klinton”, kundër debitorit “Fast Energy” L.L.C., me NUI:811369075, me seli në Prishtinë Rr.”Isa Kastrati” pn., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.984/21 të datës 22.11.2021, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 22.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “Fast Energy” L.L.C., me NUI:811369075, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.984/21 të datës 22.11.2021 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Luani Consulting” SH.P.K., me NUI:810867228, me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.507/21 të datës 29.04.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – fatura me numër 072621022-51 e datës 26.07.2021; fatura me numër 062121002-51 e datës 21.06.2021; fatura me numër 051721023-51 e datës 17.05.2021; fatura me numër 042621019-51 e datës 26.04.2021; fatura me numër 041321012-51 e datës 13.04.2021; fatura me numër 032621007-51 e datës 26.03.2021; fatura me numër 032621004-51 e datës 26.03.2021; fatura me numër 031621008-51 e datës 16.03.2021; fatura me numër 031521007-51 e datës 15.03.2021; fatura me numër 031321004-51 e datës 13.03.2021; fatura me numër 031321014-51 e datës 13.03.2021; fatura me numër 030521011-51 e datës 05.03.2021; fatura me numër 030521010-

51 e datës 05.03.2021; fatura me numër 030221003-51 e datës 02.03.2021; fatura me numër 010621006-51 e datës 06.01.2021; fatura me numër 010421007-51 e datës 04.01.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 20,358.18 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbaremit me dhunë, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përmbareusi privat zbaton përmbareimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori ka parashtruar prapësim përmes të cilit e kundërshton urdhrin përmbareimor, ndër të tjerash ka theksuar se urdhri përmbareim si dhe shkresat e lëndës i janë dërguar gabimisht parashtrueses së prapësimi pa qenë pronare e as punëtore e “Fast Energy” L.L.C., dhe këtë dokumentacion e ka pranuar një familjar i saj. Ka shtuar se e ka njoftuar përmbareusin privat se nuk është pronare e debitorit në fjalë duke ia kthyer komplet shkresat në mënyrë që t'ia dërgoj në adresën e saktë. Tutje ka theksuar se parashtruesja e këtij prapësimi asnjëherë nuk ka marr apo pranuar mall nga kreditori në fjalë si dhe nuk ka asnjë bashkëpunim me të dhe as që e njeh këtë kompani. I ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit respektivisht parashtrueses së këtij prapësimi dhe urdhri përmbareimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se vërehet qartazi se qëllimi i tij është vetëm tentimi tij për ti ikur pagesës së borxhit dhe atë përmes paraqitjes së një skeme të mashtrimit me tendencë të shtyrjes dhe prolongimit të pagesës së borxhit. Ka shtuar se me rastin e fillimit të procedurës përmbareme me datë 19.11.2021 në ARBK, si pronar i debitorit ka qenë e regjistruar M.M., ku janë të bashkangjitura edhe dokumenti i nxjerr. E më pastaj me datë 20.12.2021 është ndryshuar pronari i debitorit tani me pronar M.G.. Ka theksuar se tentimi i bishtnimit të bashkëshortëve M.M. dhe M.G. është i qëllimshëm për shtyrjen e pagesës së borxhit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pa bazuar dhe urdhri përmbareim të mbetet në fuqi. Si dhe ti kompensohen shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim..

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.984/21 të datës 22.11.2021, të Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj, e ka pranuar me datë 24.12.2021, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 10.01.2022.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbarimor P.nr.984/21 të datës 22.11.2021, e ka pranuar me datën 24.12.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 25.12.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 31.12.2021.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 10.01.2022, në zyrën e përmbaruesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me njëzet e tre ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1601/22, datë 22.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.